

SH P A L L J E

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës Shpallë këto vende të lira të punës :

- 1) ZYRTAR PËR OPERATIVË FINANCIARE TË BSPK- me kontratë me periudhë të caktuar të punës - një vit
- 2) ZYRTARË/E PËR STATISTIKË DHE QËSHTJE EKONOMIKE TË BSPK-ës- me kontratë me periudhë të caktuar të punës- një vit
- 3) PUNËTORË/E PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTIS DHE HIGJENËS NË BSPK- me kontratë për punë dhe detyra specifike

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës me të cilat ngarkohet

I- ZYRTARI/JA PËR OPERATIVË FINANCIARE TË BSPK:

- Hartimi i listave dhe bërja e pagesave në të gatshme, sipas dedikimeve të
- caktuara, në bazë të urdhërit të përgjegjësit,
- Përgaditja e dokumentacionit të nevojshëm për pagesa me llogari bankare sipas rregullave për transfer parash, në bazë të urdhërit të përgjegjësit,
- Përcjellja dhe kujdesja për aplikimin e rregullave ligjore që kanë të bëjnë me punët e arkës,
- Kujdesja për mos tejkalimin e maksimumit të saldosh në arkë, të përcaktuar me vendim,
- Bërja e pagesave dhe inkasimit në arkë të BSPK dhe llogaritjen bankare të këtij subjekti sindikal,
- Bërja e regjistrimit të dokumenteve financiare në urdhëresën e arkës për inkasim,
- Regjistrimi i dokumentave financiare në urdhëresën për pagesë,
- Në harmoni me rregullat financiare bënë përpilimin e ditareve të arkës,
- Lëshon dëftesa dje kryen punë nga lëmi i operativës financiare,
- Sipas nevojës për subjektet e caktuara ekonomike, ndihmon, përpilon dhe barazon dokumentacionin e nevojshëm për shpërndarjen e 20%-shit të shitjes së ndërrmarrjeve të privatizuara nga AKP, dhe mban përgjegjësi për shpërndarjen e rregullt të tyre,
- Udhëheq librat regjistruar të faturave hyrëse,
- Udhëheq librat regjistruar të faturave dalëse,
- Asiston dhe e prezenton dokumentacionin e arkës dhe operativës financiare të nevojshëm për auditim nga auditorët e mbrendshëm dhe të jashtëm,
- Kujdeset për ruajtjen e shenimeve në disketa,

- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të Kryetarit të BSPK dhe nënkryetarit për qështje ekonomike të këtij subjekti;
- Për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të BSPK dhe nënkryetarit për qështje ekonomike të këtij subjekti.

Kushtet të cilat duhet plotësuar:

- Përgaditja shkollore- Fakulteti ekonomik 4(katër) vjeqar ose Fakulteti ekonomik me sistemin e Bolonjës dhe Masteri nga ky lëmi,
- Përvoja në punë- 3(tri) vite në profesion,
- Njohja e punëve me kompjute Word.Exel, Paint dhe internet.

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës me të cilat ngarkohet

II-ZYRTARI/JA PËR STATISTIKË DHE QËSHTJE EKONOMIKE TË BSPK-ës:

- Përcjellë dhe kujdeset për aplikimin e rregullave ligjore që kaanë të bëjnë me punët ekonomike dhe qështjet statistikore,
- Sipas nevojës për subjektet e caktuara ekonomike, ndihmon, përpilon dhe barazon dokumentacionin e nevojshëm për shpërndarjen e 20%-shit i shitjes së ndërmarrjeve të privatizuara nga AKP, dhe mbanë përgjegjësi për shpërndarjen e rregullt të tyre,
- Mban shënime statistikore për nevoja të BSPK-ës, por nuk guxon ti bëjë publike pa lejen e kryetarit të këtij subjekti,
- Hulumton dokumentacione të ndryshme për financimin e projekteve në dobi të BSPK-ës,
- Kujdeset për ruajtjen e shënimeve në disketa,
- Kryen edhe punë tjera me urdhër të kryetarit të BSPK-ës dhe nënkryetarit për qështje ekonomike të këtij subjekti,
- Për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të BSPK-ës dhe nënkryetarit për qështje ekonomike të këtij subjekti.

Kushtet të cilat duhet plotësuar:

- Përgaditja shkollore- Fakulteti ekonomik 4(Katër) vjeqar ose sistemi i Bolonjës dhe Masteri nga ky lëmi,
- Përvoja në punë- 3(tri) vite në profesion,
- Njohja e punëve me kompjute Word.Exel, Paint dhe internet.

Përshkrimi i punëve dhe detyrave të punës me të cilat ngarkohet

III-PUNËTORË/E PËR MIRËMBAJTJEN E PASTËRTIS DHE HIGJIENËS NË BSPK:

- Mbanë dhe kujdeset për pastërtin dhe higjienën, brenda objektit dhe rrethojës së BSPK-ës.

Kushtet të cilat duhet plotësuar:

- Përgaditja shkollore- shkollimi i mesëm,
- Përvoja në punë- 1 vit

Dokumentacioni i kërkuar dorzohet në lokalet e BSPK-ës, rr. Qamil Hoxha nr. 8.
Shpallja mbetet e hapur 5(pesë) ditë pas shpalljes së sajë në Web faqen dhe tabelen e shpalljeve të BSPK-ës.

Prishtinë
28.03.2017

Kryetari i BSPK-ës
Haxhi Arifi